



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

### Subjekti:

Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore  
Llogaria e aktiviteteve vetëfinanciare 787

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i paitueshmërisë për vitin 2020

**Qëllimi i revizionit:** të fitohet bindje e arsyeshme nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet që reflektojnë në raportet financiare janë në gjitha aspektet materiale, në pajtim me rregullativën ligjore përkatëse udhëzimet dhe politikat e vendosura.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- Nuk është vendosur kontrolli dhe menaxhimi përkatës financiar dhe nuk është vendosur ndarja e përgjegjësisë dhe detyrave në pjesën e punës financiare;
- Mos vendosja e kontrollit të mjedisit efikas dhe të plotë për shkak të mos plotësimit të vendeve drejtuese;
- Mos vendosja e kontrollit dhe mënyra e çrregullt e evidencës, llogaritjes dhe arkëtimit të të hyrave;
- Mos vendosja e evidencës analitike dhe mungesa e të dhënave për shumën e arkëtimit të hyrave për secilin lloj të certifikatëve ose miratim që lëshohet.

### Mendimi i dhënë \*:

Revizioni përmbahet nga dhënia e mendimit në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare, si dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2020.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

Është e nevojshme të rregullohen aktet ligjore dhe nënligjore në drejtim të:

- Përcaktimit të afateve për veprim në një pjesë të procedurave për lëshimin e certifikatave dhe miratimeve;
- sigurimi i transparencës në mënyrën se si kryhen provat klinike dhe përcaktimi i përqindjes së pjesëmarrjes të fondeve që duhet të jenë të ardhura të ISHP
- Ndryshimi i Ligjit për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore me qëllim që të lehtësohet vendosja në treg të barnave për trajtimin e sëmundjeve që do të shkaktonin epidemi ose pandemi.

### Rekomandimet kyçe:

- plotësimin e vendeve të punës në Departamentin e Çështjeve Financiare dhe pozicionet e parashikuara drejtuese në sektorë
- miratimi dhe caktimi i procedurës për llogaritjen dhe arkëtimi i të ardhurave dhe zbatimi i plotë i tijë
- Vendosjen e evidencës së kontabilitetit analitik për të gjitha të hyrat

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft Raportin e Revizorit të Autorizuara Shtetëror.

\* pozitive, me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur